




Bazalioma, Spinalioma

Format non-melanocitare, të ashtuquajturat, të çelëta, të kancerit

Struktura (prerja) e lëkurës



Lëkura

Lëkura është organi më i madh dhe më i rëndë i njeriut. Ajo i mbron organet e brendshme nga ndikimet e jashtme, si vapa, lagështira ose presioni (trysnia), shmang shkaktarët e sëmundjeve dhe rregullon temperaturën e trupit. Lëkura është e ndërtuar nga shtresa dhe qeliza të ndryshme.

Ekzistojnë disa lloje kancerësh lëkurorë. Melanoma, (kanceri i zi i lëkurës) dhe format non-melanocitare, të ashtuquajturat – të çelëta, të kancerit lëkuror (spinalioma, bazalioma). Këto sëmundje zhvillohen në mënyra të ndryshme prandaj edhe trajtohen në mënyra të ndryshme. Për pasojë, në vazhdim bëhet fjalë vetëm për formën e çelët të kancerit.

Në rastin e kancerit lëkuror të çelët dallohet bazalioma (Karcinoma qelizore bazale) dhe spinalioma (karcinoma spinocelulare). Bazalioma e ka prejardhjen nga qelizat bazale të lëkurës. Prej tyre krijohen qelizat e reja lëkurore, të cilat tërhiqen drejt faqes së jashtme të lëkurës. Spinalioma krijohet nga qelizat gjembore; këto prodhojnë substancën gungore të lëkurës, keratinin.

Bazaliomat dhe spinaliomat shfaqen shumë më shpesh se sa melanomat. Mirëpo këto janë më pak të rrezikshme, sepse praktikisht nuk krijojnë metastaza kurrë (bazalioma) ose rrallë (spinalioma).

Incidenca

Në Zvicër çdo vit sëmurën rreth 15000 persona nga kanceri i lëkurës:

- > Rreth 10% të pacientëve (rreth 1800 persona) kanë një melanomë.
- > Rreth 90% të pacientëve (rreth 13500 persona) kanë një bazaliomë ose një spinaliomë.

Bazalioma është pakrahasimisht kanceri më i përhapur lëkuror – shfaqet tre deri katër herë më shpesh se sa spinalioma. Femrat dhe meshkujt preken pothuajse njësoj prej tij. Në të kundërtën, nga spinalioma sëmurën më shumë meshkuj se sa femra. Kanceri lëkuror i çelët paraqitet para së gjithash te burrat në moshë. Moshë mesatare tek bazalioma sillet tek ajo 60 vjeçe, tek spinalioma 70 vjeçe.

Simptomat

Bazalioma dhe spinalioma krijohen të shumtën e rasteve në pjesët lëkurore që i janë ekspozuar së tepërmi diellit, dmth. hundës, ballit, buzëve, veshëve, shpinës së duarve ose në kokën e shogët (pa qime).

Simptomat tipike janë:

- > Ndryshime në formë nyjash, kokrra (kombe) ose çibane (ulcera) të lëkurës
- > Nyja «kristalore» me shfaqje të qartë të damarëve të gjakut
- > Çibane lëngësuese të pashërueshme
- > Gungëzime rezistente (të ngulmëta), të cilat pas lëndimit lëshojnë pakëz gjak ose lëng dhe janë të mbuluara me leskra

Ndryshimet e dyshimta lëkurore duhen sqaruar gjithmonë nga mjeku ose mjekja (dermatologe), sepse sa më herët që të zbulohet kanceri i lëkurës, aq më të mëdha janë shanset për shërim.

Diagnozat dhe kontrollet

Mjeku/-ja i/e lëkurës fillimisht do të observojë me saktësi pjesët e dyshimta të lëkurës, në mes tjerash me ndihmën e një lloj thjerrëze, me dermatoskop. Po të ekzistojë dyshimi për kancer lëkure, mjeku i lëkurës do të shkëpusë nën një anestezi lokale kampione indesh ose madje mund të presë njollën lëkurore të tërën. Më pas indi do të ekzaminohet me saktësi në laborator me qëllim konstatimi të llojit të tumorit.

Për të konstatuar se në ç'masë është zgjeruar tumori në thellësi të lëkurës ose në organe të tjera, sipas rrethanash do të zbatohen edhe ekzaminime të tjera, për shembull një ultratingull i nyjave fqinje limfatike ose një tomografi kompjuterike ose ajo e rezonancës magnetike.

Stadet e sëmundjes

Sëmundjet kanceroze ndahen sipas sistemit TNM. Me këtë rast gjykohet mbi zgjerimin e tumorit (T), invadimin e nyjave limfatike (N) dhe eventualisht për prani metastazash (M).

Bazalioma rritet shumë ngadalë. Ajo nuk krijon praktikisht kurrë metastaza, për ç'shkak ndarja e saj sipas sistemit TNM nuk është e arsyeshme. Më e rëndësishme është që të përcaktohet zgjerimi i saj horizontal dhe thellësia e depërtimit. Sepse bazalioma mund të rritet në thellësi dhe të shkatërrojë indet që gjenden nën lëkurë, psh. kockat ose kërcet.

Edhe *spinalioma* rritet mengadalë. Mirëpo përkundër bazaliomës, në stadet e tij të përparuara ajo mund të invadojë nyja limfatike dhe të krijojë metastaza në organe të largëta. Spinalioma ndahet si vijon:

- T0** S'ka prani spinaliome
- T1** Spinalioma është më së shumti 2 cm e madhe
- T2** Spinalioma është e madhe midis 2 dhe 5 cm
- T3** Spinalioma është më e madhe se 5 cm
- T4** Spinalioma ka invaduar indet fqinje, si muskujt, kërcet ose eshtrat.
- Tx** Zgjerimi i saj nuk mund të gjykohet dot
- N0** Nuk ka nyja të invaduar limfatike
- N1** Janë invaduar nyjat fqinje limfatike
- Nx** Invadimi i nyjave limfatike nuk mund të gjykohet dot

M0 S'ka metastaza

M1 Ka metastaza në organe tjera, p.sh. ne mushkëri ose veshka

Mx Prania e metastazave nuk mund të gjykohet dot

Terapia

Shanset për shërim në rastin e kancerit lëkurore të çelët janë shumë të mira, para së gjithash kur ai trajtohet në një stad të hershëm. Sipas rregullit, tumori hiqet në rrugë kirurgjike. Pas një ndërhyrjeje të vogël, qepet plaga. Nëse duhet hequr ndonjë pjesë e madhe lëkure, mbyllja e plagës shpesh është më e zorshme: duhet tërhequr lëkurën nga zonat organike kufitare ose duhet bërë ndonjë transplantim lëkure.

Përpos operacionit, në rastin e kancerit lëkurore të çelët ekzistojnë një sërë veprimesh të tjera terapeutike:

- > Kuretazhi: rruajtja (kositja) sipërfaqësore e tumorit.
- > Kirurgjia lazerike: shkatërrimi (zbërthimi) i tumorit me ndihmën e lazerit
- > Terapia e akullit (Kryoterapia): shkatërrimi i qelizave tumorale përmes ngrirjes.
- > Trajtimi me elektricitet (Elektrodesikacion): shkatërrimi i qelizave tumorale me impulse elektrike
- > Terapia radiologjike (radioterapia): shkatërrimi i qelizave tumorale përmes rrezatimit.
- > Terapia medikamentoze: sipër tumorit vendoset një krem me substanca ndikuese speciale, të cilat nxisin një pezmatim. Kësisoj vriten qelizat tumorale.
- > Terapia fotodinamike: vendoset një lloj kremi, i cili përmban substanca të ndjeshme ndaj dritës; këto do të thithen prej qelizave tumorale. Më pas tumori i nënshtrohet një ndriçimi të fortë. Tek qelizat tumorale kjo do të shkaktojë të ashtuquajturin reaksion fototoksik, dhe në këtë mënyrë – shkatërrimin e tyre.
- > Kimioterapia: zbatohet vetëm atëherë kur spinalioma tashmë ka krijuar metastaza.
- > Imunoterapia

Se kur dhe cili veprim do të gjejë zbatim nuk varet vetëm nga lloji dhe stadi i tumorit, por edhe nga moshë dhe nga gjendja shëndetësore e pacientit apo pacientes. Përpos kësaj, ka rëndësi se cili vend i trupit është prekur, ngaqë disa lokacione nuk janë të përshatshme për një operacion (psh. veshi ose këndi i syrit).

Pasojat e trajtimit

Pas heqjes operative të tumorit mbetet një vragë, e cila, sipas rregullit, nuk përbën ndonjë shqetësim. Nëse si rezultat i operacionit krijohen defekte të mëdha lëkurore ose në inde, më pas këto mund të përmerësohen shpesh përmes një operacioni të mëvonshëm plastik.

Paskontrollet

Pas përfundimit të trajtimit për kancer, pacientët duhet ta vizitojnë rregullisht mjekun / mjeken për kontrolle të mëpasme përkujdesëse. Ai/ajo do t'i japë secilit pacient rekomandime individuale se cilat kontrolle në cilin hark kohor janë të domosdoshme.

Faktorët rrezikues

Të ekspozuarit e shpeshtuar dhe shumëvjeçar nën rrezet UV (Ultraviolet) shton rrezikun për kancer të çelët lëkure. Shpesh tumori krijohet në ato lokacione lëkurore të cilat qysh më parë kanë qenë të dëmtuara nga rrezet UV. Faktorë të tjerë rrezikues janë pezmatimet lëkurore të plagëve (apo plagët), kontakti me substanca nxitëse kanceroze, si katrani ose arseniku, një dobësim imunitar ose sëmundje të rralla trashëgimore.

Parandalimi dhe zbulimi i hershëm

Masa më e rëndësishme për parandalimin e kancerit lëkurore është një mbrojtje efektive nga rrezet UV (ultravjollcë):

- > Shmangia me çdo kusht e djegies nga dielli.
- > Midis orës 11 dhe 15, atëherë kur ngarkesa me rreze UV është më e larta, duhet ndenjur nën hije.

- > Në kohën me diell të barten kapele, syze diellore ose rroba të përshtatshme.
- > Krem mbrojtës ndaj diellit me faktor të lartë mbrojtës nga rrezet
- > Foshnjat deri në moshën njëvjeçare të mos ekspozohen kurrë direkt në diell
- > Veçanërisht mirë të mbrohen fëmijët nga dielli.

la vlen që lëkurën ta kontrollojmë vetë në distanca të rregullta kohore dhe nishanet (lezionet) pigmentoze t'i vëzhgojmë me saktësi. Po qe se konstatohen ndryshime në nishane, ato duhen kontrolluar tek mjeku i lëkurës.

Shënim

Ky informacion mund të shkarkohet nga www.krebsliga.ch → Krebskrankheiten (Sëmundjet kanceroze) edhe në gjuhët gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, portugalisht, serbisht-kroatisht-boshnjakisht dhe turqisht. Mos harroni dhe broshurat tona falas në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht nën www.krebsliga.ch/broschueren.

Informacion, Këshillim, Mbështetje

Krebsliga Aargau

Tel. 062 834 75 75
www.krebsliga-aargau.ch

Krebsliga beider Basel

Tel. 061 319 99 88
www.krebsliga-basel.ch

Bernische Krebsliga Ligue bernoise contre le cancer

Tel. 031 313 24 24
www.bernischekrebsliga.ch

Ligue fribourgeoise contre le cancer

Krebsliga Freiburg
tél. 026 426 02 90
www.liguecancer-fr.ch

Ligue genevoise contre le cancer

tél. 022 322 13 33
www.lgc.ch

Krebsliga Glarus

Tel. 055 646 32 47
www.krebsliga-glarus.ch

Krebsliga Graubünden

Tel. 081 252 50 90
www.krebsliga-gr.ch

Ligue jurassienne contre le cancer

tél. 032 422 20 30
www.liguecancer-ju.ch

Ligue neuchâteloise contre le cancer

tél. 032 721 23 25
www.liguecancer-ne.ch

Krebsliga Schaffhausen

Tel. 052 741 45 45
www.krebsliga-sh.ch

Krebsliga Solothurn

Tel. 032 628 68 10
www.krebsliga-so.ch

Krebsliga St. Gallen- Appenzell

Tel. 071 242 70 00
www.krebsliga-sg.ch

Thurgauische Krebsliga

Tel. 071 626 70 00
www.tgkl.ch

Lega ticinese contro il cancro

tél. 091 820 64 20
www.legacancro-ti.ch

Ligue valaisanne contre le cancer

tél. 027 322 99 74
www.lvcc.ch

Krebsliga Wallis

Tel. 027 922 93 21
www.krebsliga-wallis.ch

Ligue vaudoise contre le cancer

tél. 021 641 15 15
www.lvc.ch

Krebsliga Zentralschweiz

Tel. 041 210 25 50
www.krebsliga.info

Krebsliga Zug

Tel. 041 720 20 45
www.krebsliga-zug.ch

Krebsliga Zürich

Tel. 044 388 55 00
www.krebsliga-zh.ch

Krebshilfe Liechtenstein

Tel. 00423 233 18 45
www.krebshilfe.li

Krebstelefon / Ligne Info- Cancer / Linea cancro

0800 11 88 11
Nga e hëna në të premten,
ora 10–18. Gjermanisht,
frëngjisht, italisht; falas

migesplus

Schweizerisches Rotes Kreuz
3084 Wabern
Tel. 031 960 75 71
www.migesplus.ch
Informacione për migrante
dhe migrantë

Impressum

Autore

Dr. med. Eva Ebnöter,
Zollikon

Përkthimi

Bislim Elshani, migesplus

Ilustrimet

Daniel Haldemann, Wil SG

Botues

Krebsliga Schweiz
Effingerstrasse 40
Postfach 8219
3000 Bern
Telefon 031 389 91 00
www.krebsliga.ch

© 2010

Krebsliga Schweiz, Bern